



Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës

PREAMBULA

Liria e informimit është një ndër të drejtat themelore në çdo shoqëri demokratike dhe bazë për t'ua mundësuar njerëzve të marrin pjesë në mënyrë aktive në institucionet demokratike dhe në opinionin shoqëror dhe politik si dhe në proceset vendimmarrëse. Mediet e shkruara, si mediumi më i vjetër, luajnë një rol të rëndësishëm duke iu siguruar qytetarëve informata të rëndësishme, të sakta dhe të paanshme.

Mediat e shkruara, gazetat dhe agjencitë e lajmeve, redaktorët e gazetarët e tyre, kanë detyrë të veçantë që të përmbushin nevojat e shoqërisë për t'u informuar, të mbrojnë të drejtat themelore njerëzore të secilit person, si dhe të respektojnë të vërtetën.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është trup vetërregullues i medieve të shkruara për të siguruar që këto vlera dhe Kodi i Mediave të Shkruara të aplikohen në mënyrë të barabartë dhe në të mirë të shoqërisë dhe të qytetarëve të saj.

NENI 1 – FUSHA E VEPRIMTARISË

Këshilli i Mediave të Shkruara është organizatë joqeveritare e regjistruar e mediave të shkruara të Kosovës, ku bëjnë pjesë gazetat e përditshme, ato periodike, revistat dhe agjencitë e lajmeve, (në tekstin e mëtejshëm; Mediat e Shkruara) që garanton:

- (1) aplikimin e Kodit të Mirësjelljes së Mediave të Shkruara të Kosovës nga të gjithë anëtarët e saj,
- (2) zhvillimin e reputacionit të mediave të shkruara,

NENI 2 – EMRI, VENDI

(1) Këshilli i Mediave të Shkruara është organizatë joqeveritare e regjistruar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/22, si shoqatë vendore.

(2) Emri i plotë i KMSHK është: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës/ Press Council of Kosovo (duke iu referuar si “Këshilli i Mediave të Shkruara”).

(3) Selia e Këshillit të Mediave të Shkruara është në Prishtinë, Republika e Kosovës.

(4) Viti fiskal është i barabartë me vitin ligjor kalendarik.

NENI 3 – QËLLIMET

(1) Këshilli i Mediave të Shkruara promovon dhe zbaton Kodin e Mediave të Shkruara.

(2) Këshilli i Mediave të Shkruara shqyrton ankesat lidhur me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara nga ana e mediave të shkruara të Kosovës.

(3) Këshilli i Mediave të Shkruara vendos për masat ndëshkuese nëse ankesa konsiderohet të jetë e arsyetuar.

(4) Anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara veprojnë në mënyrë të pavarur. Përfaqësuesi i Medias së Shkruar, rasti i të cilit shqyrtohet, nuk ka të drejtë të votojë.

(5) Mediat anëtare të Këshillit të Mediave të Shkruara publikojnë pa pagesë vendimet e Këshillit të Mediave të Shkruara.

(6) Anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara publikojnë pa pagesë informatat për Kodin e Mediave të Shkruara si dhe për Procedurën e Ankesës, nëse Anëtarët e Bordit e kërkojnë këtë gjë.

NENI 4 – ANËTARËSIMI

(1) Anëtarët e Këshillit të Mediave të shkruara janë nënshkruesit e këtij Statuti, respektivisht:

- Mediat e shkruara të Kosovës të përfaqësuara nga kryeredaktorët apo të deleguarit e mediave të shkruara të Kosovës, dhe
- Tre anëtare të pavarur.

(2) Tre anëtarët e pavarur propozohen dhe zgjidhen me shumicë votash nga kryeredaktorët anëtarë, apo të deleguarit e tyre në KMSHK. Ata zgjidhen me afat kohor prej një viti dhe mund të rizgjidhen për herë të dytë, por për një vit.

(3) Anëtarët i bashkohen Këshillit të Mediave të Shkruara duke nënshkruar Kodin e Mediave të Shkruara dhe këtë Statut.

(4) Këshilli i Mediave të Shkruara është i hapur për të gjitha mediat e shkruara të Kosovës, përfshirë edhe ato që aktualisht nuk janë nënshkruese të Statutit, si dhe për të gjitha mediat e shkruara në të ardhmen.

(5) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës merr në shqyrtim edhe ankesat që arrin kundër mediave të shkruara jo anëtare. Në këto raste, KMSHK, shpall publikisht opinion lidhur me ankesën ndaj medias së shkruar, jo anëtare e KMSHK-së. Procedura për shqyrtim dhe vendosjen për opinion, parashikohet në Rregullat e Procedurës.

(6) Anëtarësimi i mediave të shkruara përfundon përmes njoftimit me shkrim, që i dërgohet Kryetarit të Bordit të Anëtarëve dhe me afat paralajmërimi prej një muaji, apo me përjashtim. Anëtarësimi i tre anëtarëve të pavarur përfundon pas skadimit të mandatit, apo pas dorëheqjes së tyre.

NENI 5 – GRUPET

Këshilli i Mediave të Shkruara përbëhet nga Bordi i Anëtarëve të Këshillit të Mediave të Shkruara dhe nga Sekretaria e Këshillit

.

NENI 6 – BORDI

A. Përbërja

(1) Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e mediave të shkruara të anëtarësuara – kryeredaktorët apo të deleguarit e tyre, si dhe nga tre anëtarë të pavarur.

(2) Tre anëtarët e pavarur kryejnë funksionet e kryetarit dhe nënkryetarëve të Bordit .

(3) Nënkryetari i dytë do të jetë pjesëtar nga grupet minoritare.

(4) Bordi i Anëtarëve takohet së paku një herë në muaj. Kryetari i Bordit paralajmëron takimet një javë përpara.

(5) Takimet drejtohen nga Kryetari apo cilido prej dy nënkryetarëve të Bordit të Anëtarëve.

(6) Kryeredaktorët anëtare të rregullt të Bordit paguhen në shumë prej 30 euro për secilin takim, në të cilin marrin pjesë, të deleguarit e kryeredaktorëve paguhen me 30 euro, nënkryetari paguhet me shumë prej 60 euro, kurse kryetari i Bordit paguhet me 100 euro për secilin takim, në të cilin merr pjesë. Shpenzimet e anëtarëve të cilët vijnë nga vendet jashtë Prishtinës kompensohen me shumë prej 0.10 centë për kilometër.

B Përgjegjësitë

Bordi i anëtarëve

- 1) Zgjedh kryetarin dhe nënkryetarët me votë të fshehtë të shumicës.
- (2) emëron drejtorin e Sekretarisë dhe nëpunësin për ankesa të Sekretarisë dhe vendosë për kushtet e kontratës së tyre,
- (3) vendos për buxhetin vjetor dhe shpall raportin financiar në fund të secilit vit fiskal,
- (4) përpunon rregullat e procedurës,
- (5) vendos për procedurat e ankesave,

(6) vendos për validitetin e ankesës dhe masat që merren në rast të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara,

(7) promovon dhe zbaton Kodin e Mediave të Shkruara,

(8) mund ta ndryshojë Kodin e Mediave të Shkruara,

(9) zgjidh konfliktet mes paditësit dhe medias së shkruar, anëtare e KMSHK-së, përmes ndërmjetësimit.

C. Kompetencat

(1) Bordi vendos për validitetin e ankesës.

(2) Ankesat për gazetarët individë nuk shqyrtohen. Ankesat pranohen vetëm nëse drejtohen kundër medias të përkatësisë të shkruar .

(3) Bordi mund të refuzojë të shqyrtoje ndonjë rast. Në këtë rast, Këshilli i Mediave të Shkruara informon paditësin për arsyet e refuzimit të ankesës.

(4) Takimet e Bordit janë publike, posaçërisht për vëzhguesit e mediave, përveç nëse Bordi vendos ndryshe.

(5) Bordi ka kompetenca të urdhëroje medien përkatëse të botoje ose të paraqesë në ueb faqen e agjencisë që Bordi e cakton, vendimin e marre nga Bordi.

(6) Bordi ka kompetenca të përfundojë anëtarësimin e secilës medie të shkruar, që nuk përfill vendimet e tij. Bordi ka kompetenca të përjashtojë një media nga anëtarësimi i tij me 75 % të votave të anëtarëve.

(7) Bordi ka kompetenca të ndryshojë Kodin e Mediave të Shkruara me 75 % të votave të anëtarëve.

NENI 7 – SEKRETARIA

Përbërja

(1) Sekretaria përbëhet nga një drejtor, i punësuar me orar të plotë pune, dhe një zyrtar për ankesa, po ashtu me orar të plotë pune.

(2) Drejtori dhe zyrtari për ankesa janë të pavarur nga ndikimi partiak dhe politik.

(3) Drejtori dhe zyrtari për ankesa zgjedhën dhe emërohen nga Bordi i Anëtarëve.

Funksionet

Sekretaria dhe stafi i saj:

(1) janë përgjegjëse për punët administrative të Këshillit të Mediave të Shkruara dhe sigurojnë qarkullim korrekt dhe transparent të informatave si dhe korrespondencën në mes paditësve, mediave të shkruara dhe Bordit të Anëtarëve,

(2) përgatisin raportin financiar dhe propozojnë buxhetin për Bordin e anëtarëve,

(3) përgatisin rregullat për procedurën e ankesës,

(4) zbatojnë vendimet e Bordit,

(5) kryejnë detyra të tjera.

NENI 8 – FINANCIMI

(1) Mediat e anëtarësuar kontribuojnë financiarisht në buxhetin e Këshillit të Mediave të Shkruara.

(2) Për çdo vit ky kontribut është 800 euro për gazetat ditore, 1/6 e 800 eurove për gazetat javore, 1/12 e 800 eurove për gazetat dyjavore dhe 1/24 e 800 eurove për gazetat mujore dhe për agjencitë e lajmeve ¼ e 800 eurove. Për secilin vit vijues kontributi rritet karshi tarifës së inflacionit në eurozonë, e cila jepet nga Banka Qendrore Evropiane.

(3) Kontributi mund të paguhet në dy këste. Kësti i parë paguhet më 15 janar të secilit vit kalendarik, dhe kësti i dytë paguhet më 15 korrik të secilit vit kalendarik, që fillon më 1 janar të çdo viti kalendarik.

NENI 9 – PROCEDURAT

(1) Duhet të ekzistoj kuorumi i Bordit në të cilin duhet do të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit të Mediave të Shkruara. Kuorumi përfshin kryetarin e Bordit ose njërin nga nënkryetarët.

(2) Të gjitha votimet e kryera nga Bordi i anëtarëve përfillin rregullat e votimit të fshehtë të shumicës së atyre që janë të pranishëm, përveç nëse përcaktohet ndryshe. Nëse nuk arrihet shumica, atëherë kryetari i Bordit ose nënkryetari i Bordit, në mungesë të tij, e ka të drejtën e votës vendimtare.

(3) Këshilli i Mediave të Shkruara vendos dhe i bënë publike rregullat e tij të procedurave.

(4) Këshilli i Mediave të Shkruara i vendos dhe i bën publike procedurat e tij të ankesave. Këto janë pjese shtojcë e këtij Statuti.

(5) Çdo banor i Kosovës i definuar në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, posaçërisht ai që ndihet i fyer ka të drejtë të dorëzojë ankesë.

(6) Bordi nuk pranon ankesa nga njëri anëtar i KMSHK kundër anëtarit tjetër.

(7) Ky statut mund të ndryshohet vetëm me 75 % të shumicës së Bordit të anëtarëve.

(8) KMSHK mund të shpërbëhet vetëm me vendim të 75 % të anëtarëve të Bordit . Çdo vlerë (pasuri) që mbetet pas shkarkimit të përgjegjesisë së KMSHK duhet t`iu shpërndahet trupave që do të përcaktohen nga Bordi.

(9) Ky statut është në tri versione gjuhësore: shqip, serbisht dhe anglisht. Versioni në gjuhën shqipe është bazë.

(10) Ky statut hyn në fuqi më 10 gusht 2005. Ky statut është plotësuar më 26 Janar 2010 dhe është miratuar nga anëtarët, sipas procedurës së paraparë në statut.

Ne deklarojmë se e pranojmë dhe pajtohem me këtë Statut të cilit do t'i përmbahemi.

Prishtinë, 11 maj 2010

<u>Mediumi</u>	<u>Emri dhe mbiemri</u>	<u>Nënshkrimi</u>
Epoka e Re	<u>Besim Cemeraj</u>	<u>[Signature]</u>
Lajm	<u>DRITON LATIFI</u>	<u>[Signature]</u>
Alem	<u>NADIRA AVARË VILAS'</u>	<u>[Signature]</u>
Koha Ditore	<u>AGRON BAJRAMI</u>	<u>[Signature]</u>
Zëri	<u>Bekhet Haliti</u>	<u>[Signature]</u>
Bota Sot	<u>[Signature]</u>	<u>[Signature]</u>
Yeni Donem	<u>[Signature]</u>	<u>[Signature]</u>
Kosova Sot	<u>Jusuf Mego</u>	<u>[Signature]</u>
Infopress	<u>Armi Azemi</u>	<u>[Signature]</u>
M Magazine	<u>Fadil Miftari</u>	<u>[Signature]</u>
Tribuna Shqiptare	<u>FITIM UKA</u>	<u>[Signature]</u>
Sport	<u>BESNIK BATUŠHA</u>	<u>[Signature]</u>
KosovaLive	<u>KELMEND HAPÇIU</u>	<u>[Signature]</u>
KosovaPress	<u>Fadil Bajraktari</u>	<u>[Signature]</u>
InfoSot	<u>Fatlum Rrahmani</u>	<u>[Signature]</u>

